



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 31-03 2016		
Primiçeno:		
Vlera Jednica	Numri Eroj	Shifra Dokalesk
12-320-	16187	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

THIRJE PËR APLIKIM

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është përkrahja e fermerëve në fushën e perimkulturës dhe pemtarisë. Sipas Pasqyrës buxhetore për vitin 2016. Fermerët do të përkahen me nga 1 ari Serrë , dhe nga 10 ari Fidane të Mjadrës të llojit Polka me Sistem të Ujitjes.

II. Përfituesit e pranueshëm

Përfituesit e pranueshëm janë personat Fizik-Fermer. Ata duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Lipjanit , si dhe prona duhet të jetë në territorin e Komunës së Lipjanit.

III. Kriteret e përgjithshme të pranueshme

- Aplikuesit duhet të dorëzojnë kërkesën e plotësuar , dhe formularin për aplikim, të cilat merren në zyrat pritëse të Komunës (ku edhe dorëzohen dokumentet e plotësuara)
- Aplikuesit duhet të kenë të hapur llogari të vlefshme bankare
- Toka në përdorim duhet të jetë në pronësi të aplikuesve
- Përparësi kanë aplikuesit të cilët dëshmojnë se kanë vijuar trajnime relevante/specifike në lëminë e Perimkulturës ose Pemtarisë.
- Përparësi kanë fermerët që kanë burim të ujit të mjaftueshme të ujitjes
- Aplikuesi nuk mund të jetë në mardhënje pune me Institucionin që bën përkrahjen
- Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore-minimum 100m² në lokacionin ku ndërtohet serra, dhe 1000m² në lokacionin ku ngritet pemishtja me mjedër.

IV. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirrja për aplikim do të jete e hapur 15 ditë nga data e publikimit,
- Fermeri duhet të participoj me 20% të çmimit furnizues (pagesa e kësaj shume bëhet pas njoftimit të fermerit që është përfitues dhe para marrjes së serrës dhe pagesa duhet të bëhet përmes transferit bankar).
- Aplikimi bëhet në Arhivën e Komunës së Lipjanit.

V. Përzgjedhja

- Aplikimet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim,
- Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren nga komisioni i cili do të bëjë vlerësimin duke u bazuar edhe në disa kritere shtesë të paraqitur në një pyetësor (përveç atyre të caktuara në këtë udhëzues),
- Përfituesi do të pranojë një letër konfirmuse,
- Komuna e Lipjanit do të lidhë Marrëveshje me përfituesin e serrës ose pemishtes me mjedër i cili obligohet që të mos e bëj tjetërsimin (shitje,dhënje në shfrytëzim etj.)

VI. Dokumentet e bashkangjitura

Aplikuesit duhet të dorëzojnë kërkesën e plotësuar në formularin për aplikim, së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Një kopje të letërnjoftimit (LNJ) të vlefshme të Republikës së Kosovës
- Vërtetimin mbi tatimin në pronë
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarin bankare të aplikuesit,
- Çertifikata mbi pronësinë e tokës së punueshme jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmi për ndjekjen e ndonjë trajnimit në fushën e perimkultures ose pemtarisë (e preferueshme).

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Vërejtje:

- Aplikimi mund të bëhet vetëm për njëren masë (për serrë në sipërfaqe prej 1 ari apo për fidane të mjehtës me sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 10 ari).
- Numri i përfituesve është i kufizuar.
- Fermerët të cilët kanë qenë përfitues të serrave në vitet paraprake nuk mund të jenë përfitues të serrave në këtë vitë.

Lipjan
31.03.2016

Drejtori i Bujqësisë

Feti Krasniqi

